



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1023/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Dhurata Xhahnemi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1023/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Dhurata Xhahnemi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, i parashtruar nga Dhurata Xhahnemi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0222c/01R, 0222c/05D dhe në Shkollën “Selman” Riza në Piskotë i mungojnë votat

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për pasqyrim jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave të parashtrueses së apelit, për faktin se thëniet e saj nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota

automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Dhurata Xhahnemi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjakovë, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur ndonjë formularë apo dëshmi e ndonjë dëshmitari që të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë regjistrimit të votave për kandidaten në fjalë, dhe se apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Dhurata Xhahnemi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovë, nga subjekti politik LVV, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1023/2021 më datën 07.11.2021



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.